



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1013

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së (OE) “Ananas -Impex” SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “MINISTRIA E ARSIMIT” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me ushqim dhe material higjenik për Qendrat Burimore dhe shkollat speciale” me numër të prokurimit 208 Udheheqesi-24-8228-1-2-1, me 26/12/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Ananas -Impex” SH.P.K. me nr. 2024/1013, e datës 18/10/2024, kurse vendimi i AK “MINISTRIA E ARSIMIT” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me ushqim dhe material higjenik për Qendrat Burimore dhe shkollat speciale” me numër të prokurimit 208 Udheheqesi-24-8228-1-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datën 09.08.2024 “MINISTRIA E ARSIMIT” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me ushqim dhe material higjenik për Qendrat Burimore dhe shkollat speciale” me nr. të prokurimit: 208 Udheheqesi-24-8228-1-2-1. Ndërsa me datën 30.09.2024 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës **OE “Edukimi SH.P.K.”- Prishtinë**,

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, lloji i kontratës: - furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 120,000.00 €.

Me 08.10.2024, OE “Ananas -Impex” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 09.10.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 18/10/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Ananas -Impex” SH.P.K., me nr. 2024/1013 për lidhur me aktivitetin “Furnizim me ushqim dhe material higjenik për Qendrat Burimore dhe shkollat speciale” me nr. të prokurimit: 208 Udheheqesi-24-8228-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Ananas -Impex” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti kontraktues ka dhënë deklaratën në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik, si në vijime për eliminimin e kompanisë sonë si në vijim:

Pretendimi 1- Referencat e prezantuara nga ana juaj, janë të pa rregullta dhe të pa pranueshme për AK, pasi që të gjitha referencat janë pa date të lëshimit. Edhe pse janë lëshuara nga biznese të ndryshme, çuditërisht, të gjitha janë pa date të lëshimit të tyre. Sipas kriterit të dosjes së tenderit në referencë është dashur të jepen të përshkruar data e lëshimit të tyre, në mënyrë që të vërtetohet se furnizimet janë realizuar para datës së njoftimit për kontratë.

Përgjigje në pretendimi 1 i Autoritetit kontraktues është i pavërtetë dhe i pa qëndrueshëm, pasi që në kemi dorëzuar listën e projekteve dhe referencat konform kërkesës së autoritetit kontraktues në dosje të tenderit.

Ministria e Arsimit është i vetmi autoritet kontraktues në Republikën e Kosovës që konteston referencat me sektorin privat që është në kundërshtim me LPP, sa i takon datave të referencave autoriteti kontraktues ka pas shumë të lehtë që të bëjë verifikimin e referencave të prezantuara duke shfrytëzuar mundësinë konform nenit 72 të LPP-së për të kërkuar sqarime shtesë dhe në jemi të gatshëm që t'i përgjigjemi kësaj pike me transaksione bankare.

Andaj bazuar në këtë ju është dashur të kërkonit sqarime shtesë lidhur me referencat sepse kjo është e obliguar.

Pretendimi 2 -Sipas listës së kontratave të prezantuara nga juaj si ofertues, nuk kemi ofruar dëshmi se keni realizuar ndonjë furnizim me material higjienik. Furnizimet që keni prezantuar janë komplet me produkte ushqimore të fabrikuara (vetëm Spec dhe Biber) me të cilët i keni furnizuar bizneset (qendrat tregtare), e jo ndonjë institucion, si shkollor, parashkollor (çerdhe të fëmijëve) apo të ngjashëm. Përveç se nuk keni prezantuar sipas listës së kontratave se keni furnizuar me material higjienik, edhe furnizimet që keni here me produkte ushqimore, të cilat nuk korrespondojnë me listën e produkteve që janë në paramasë, përveç biberit. Nuk keni ofruar dëshmi se keni furnizuar në 3 vitet e fundit me produkte ushqimore dhe materiale higjienike ndonjë institucion, si shkollë, çerdhe, apo të ngjashme, pasi që përmbushja e këtyre kontratave është mjaft specifike duke e pasur parasysh kategorinë e këtyre nxënësve dhe ushqimin e gatshëm që ju servohet.

Përgjigjeje ne pretendimi 2 i Autoritetit kontraktues është i pa vërtetë dhe i pa qëndrueshëm pasi qe është i vetmi autoritet kontraktues i MASHT qe konteston referencat me sektorin privat duke mos marre për baze as një dokument qe kemi prezantuar ne ofertën tone.

Ne si Kompani prodhuese kemi se paku rreth 85 produkte ushqimore te cilat i prodhojmë vet si dhe kemi një numër te madh produktesh qe ne bëjmë paketimin për operator te ndryshëm si dhe kemi përfaqësi te produkteve te ndryshme te cilat i importojmë nga vende te ndryshme për tregun e Kosovës.

Kërkesa e juaj ne dosjes e te tenderit ka kenë:

Andaj nga kjo vërtetohet se askund nuk është kërkuar qe ne duhet te furnizojmë shkollat, çerdhet apo institucione tjera publike vetëm kërkohej furnizime te ngjashme.

Sa për informimin e juaj ne jemi te përzgjedhur nga AQP për furnizimin e Institucioneve shtetërore (niveli qendror dhe lokal)qe nënkupton se ne furnizojmë me artikuj ushqimor çerdhet e Republikës se Kosovës, Manzën e Studenteve, Burgjet e Kosovës, Kazermat e FSK-se, Spitalet etj, ku vlera është milionëshe.

Pyetja ime është: Jeni ju me te mençur sesa zyrtaret e AQP-se apo përdorni ligj tjetër te Prokurimit publik sepse nga AQP me referenca te njëjta na kane shpërblye me kontrate: Furnizim me artikuj ushqimor me nr. te prokurimit UA/2016- 23-9179-1-1- 1/C434 dhe nr. te Kontratës: 07/140-2023 e cila ende është aktive dhe ende furnizojmë çerdhe, Shkolla etj.

Vien te theksohet se lista e produkteve te juaja është rreth 80% me produkte ushqimore, ne nuk kemi pare te nevojshme te ofrojmë reference për produkte higjienike edhe pse kemi kontrata te furnizimit me material higjenik.

Nuk ka qene kërkesë e juaja qe te ofrojmë reference për material higjenik andaj ne vetëm me një reference te ofruar e kemi plotësuar kërkesën e juaj. Ju ne këtë aspekt keni vepruar ne kundërshtim me realitetin e ofruar nga ana jonë.

Prentendimi 3 Nuk e keni nënshkruar dhe vulosur paramasen edhe pse e njëjta është dashur te jete e nënshkruar dhe e vulosur ju si ofertues, pasi qe formulari i paramases e kërkon një gjë te tille.

Përgjigjeje ne pretendimi 3 Autoriteti kontraktues Ministria e Arsimit ka përdor standarde te dy fishta pasi qe kërkon nga ne qe te nënshkruhet paramasa dhe është ne kundërshtim me rregullat për prokurim publik pasi qe një gjë e tillë nuk është e mundur deri sate kemi një vendim nga KRPP-ja për nënshkrimin elektronik.

Sa për dijeninë e juaj ne e-prokurim ekziston mundësia qe përshkrimi i 'çmimeve te plotësohet ne sistem dhe nga aty te dorëzohet qe nënkupton se nuk mund te nënshkruhet fizikisht dhe kjo mund te behet vetëm me nënshkrim elektronikë cili ende nuk është aktiv.

Ne momentin qe unë e kam plotësuar deklaratën nen betim nënkupton qe edhe çmimit te ofruar i qëndroj pas.

Gjithashtu ne kemi informacione nga disa kompani tjera se ju keni pranuar paramase te te pa nënshkruar dhe sipas juve ne ato raste ka qene ne rregull.

Autoriteti kontraktues Ministria e Arsimit ka përdor standarde te dy fishta pasi qe kompaninë tone e ka eliminuar nga gara për mos nënshkrim te paramases mirëpo zyrtari i prokurimit nuk e ka nënshkruar letrën standarde për eliminimin e kompanisë tone nga kjo gare.

Ne kemi kërkuar qasje ne dokumente te O.E te rekomanduar për kontrate, mirëpo

Autoriteti Kontraktues -Ministria e Arsimit na ka neglizhuar duke na dhënë qasje ne orar te caktuar dhe ne pamundësi qe te arrijmë sipas orarit ne momentin qe ne e kemi gjetur zyrën e Zyrtarit te prokurimit-Valon Alimusaj ai na thotë se jeni vonuar rreth 10 minuta dhe nuk mund te keni qasje tani si dhe na rekomandon qe te mos ushtrojmë te drejtën tone për ankese pranë Autoritet Kontraktues dhe OSHP-se.

Për te gjitha pretendimet tona janë kamerat ne objektin e MASHT-it si dhe zyrtari policor ne hyrje te objektit i cili na merr letërnjoftimin.

Ne serish kërkojmë qasje nëpërmjet email it dhe ju na thoni hajdeni pasdite dhe serish ne pasdite takohemi me drejtorin dhe zyrtarin e prokurimit ku përsëri filloni me te njëjtat kërkesa qe te mos bëjmë ankese dhe përsëri nuk na jepet qasje.

Me date 04.10.2024 ju na dërgoni njoftim se mund te kemi qasje ditën e Hënë me date 07.10.2024 nga ora 14:00- 15:00, ku kjo behet qëllimisht pasi qe afati i fundit për parashtrimin e ankesës është kjo dite ora 16:00, këtu lind dyshimi ynë se gjithçka është e qëllimshme dhe ne për ketë te padrejte dhe diskriminim qe na është bere do i drejtohem organeve përgjegjëse te Republikës se Kosovës (Prokurorisë dhe Krimeve ekonomike pranë policisë se Kosovës).

Per mo dhenjen e qasjes ne Oferten e O.E te rekomanduar konkretisht Zyrari Pergjegjes i Prokurimit ndaj te cilit kemi derguar edhe note proteste prane Komisionit Rregullativ per Prokurimi Publik qe te merren masa konforme RREGULLORE Nr.001/2022 PER PROKURIMIN PUBLIK Neni 97 Shkeljet e renda 97.1 Shkelje te renda konsiderohen:

c. Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes ne dokumenteve zyrtare sipas kërkesës me shkrim te parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tille e kërkuar është ne përputhje me nenin 10 dhe 11 te Ligjit te Prokurimit Publik.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Ananas -Impex” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59 , 60, 69 te LPP-së RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK Neni 97 Shkeljet e rënda 97.1 Shkelje të rënda konsiderohen:c. Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Operatori Ekonomik: Ananas -Impex SH.P.K., PODUJEV, si palë e pa kënaqur, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me tenderin: Fumizim me ushqim dhe material higjienik për Qendrat Burimore dhe shkollat speciale, duke pretenduar së janë bërë shkelje të dispozitave të LPP-së.

Ne si Ministri e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacioni, i kemi analizuar me vëmendje të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ju si Operator Ekonomik. Konsiderojmë së të gjitha pretendimet e juaja, janë plotësisht të pa bazuara.

Vlerësimi i tenderit është bërë në bazë të kriterëve të përcaktuara në Dosje të Tenderit, si dhe ofertës dhe dokumentacionit të prezantuar në ofertë nga ana juaj. Në bazë të atyre dokumentacioneve të prezantuar në ofertë nga ana juaj, ju jeni plotësisht i pa përgjegjshëm sipas LPP, gjegjësisht, nuk i keni plotësuar kriteret e kërkuara në dosje të tenderit.

Ne si AK-MASHTI, mbetemi prapa NJOFTIM MBI VËNDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës: 30.09.2024, si dhe të gjitha arsyeve për të cilat jeni eliminuar. Arsyeja për të cilët jeni eliminuar janë si më poshtë: Tenderi juaj është eliminuar për arsye se:

Nuk keni plotësuar kriterin lidhur me kapaciteti teknik dhe profesional. Nuk keni ofruar dëshmi se keni qarkullim të natyrës së ngjashme përmes referencave në shumën 180,000.00€.

1.Referencat e prezantuar nga ana juaj, janë të pa rregullta dhe të pa pranueshme për AK, pasi që të gjitha referencat janë pa datë e lëshimit. Edhe pse janë të lëshuara nga biznese të ndryshme, çuditërisht, të gjitha janë pa datë të lëshimit të tyre. Sipas kriterit të dosjes së tenderit, në referenca është dashur të jetë e përshkruar data e lëshimit të tyre, në mënyrë që të vërtetohet se furnizimet janë realizuar para datës së njoftimit për kontratë.

2.Sipas listës së kontratave të prezantuar nga juaj si ofertues, nuk kemi ofruar dëshmi se keni realizuar ndonjë furnizim me material higjenik. Furnizimet që keni prezantuar janë komplet me produkte ushqimore të fabrikuara (vetëm Spec dhe Biber) më të cilët i keni furnizuar bizneset (qendrat tregtare), e jo ndonjë institucion, si shkollor, parashkollorë (qerdhe të femijëve) apo të ngjashëm. Përveç se nuk keni prezantuar sipas listës së kontratave se keni furnizuar me material higjenik, edhe furnizimet që keni bere me produkte ushqimore, të cilat nuk korrespondojnë me listën e produkteve që janë ne paramasë, përveç biberit.

Nuk keni ofruar dëshmi se keni furnizuar në 3 vitet e fundit me produkte ushqimore dhe materiale higjienike ndonjë institucion, si shkolle, qerdhe, apo të ngjashme, pasi që përmbushja e këtyre kontratave është mjaftë specifike duke e pasur parasysh kategorinë e këtyre nxënësve dhe

ushqimin e gatshme qe ju servohet.

3.Nuk e keni nënshkruar dhe vulosur paramasën edhe pse e njëjta është dashur të jetë e nënshkruar dhe e vulosur ju si ofertues, pasi që formulari i paramasës e kërkon një gjë të tillë.

Asnjë agrumet shtesë (provë materiale) nuk e keni prezantuar ne Kërkesën për Rishqyrtim në mënyre qe të argumentoni atë për çka jeni eliminuar nga ky tender. Të gjitha argumentet qe keni prezantuar janë boshe: “Ne kemi kontratë me këtë institucion, Ju ndoshta punoni me ligje tjera,

Ju ndoshta jeni me te mençur si zyrtaret e autoriteteve tjera etj.” duke aluduar për ne si AK-

MASHTI. Në realitet, sipas listës se kontratave dhe referencave te prezantuara në ofertën tuaj, askund nuk është cekur se keni kontratë të lidhur apo te përfunduar me ato institucione të cilat i keni përmendur në kërkesë për rishqyrtim. Sa për të ju rikujtuar, ne ju kemi dhënë qasje 2 herë në dokumentacionin e tenderit, sipas. kërkesës tuaj. Herën e parë, ju kemi dhënë qasje të menjëhershme, por ju nuk keni qenë i përgjegjshëm për të ardhur në kohën të cilën e kishim planifikuar dhe për të cilën keni qenë të njoftuar përmes shkresës zyrtare. Këtë e keni konfirmuar edhe ju përmes parashtrësave qe na keni dërguar. Gjithashtu sipas ri-kërkesës tuaj për të pasur përsëri qasje, ne si AK ju kemi dhënë qasje dhe keni nënshkruar procesverbalin lidhur me qasjen, në të cilin keni qëkur se “Nuk kemi pasur asnjë pengese apo kufizim nga zyra e prokurimit në MASHTI-t”, i cili procesverbal është i ngritur në E-prokurimi.

Më poshtë gjeni procesverbalin lidhur me qasjen, përmes të cilit dëshmohet se ne si MASHTI, ju kemi ofruar qasje edhe për herë të dytë dhe atë të pa kufizuar konform LPP. Gjithashtu, me poshtë gjeni dëshminë se kur e keni dorëzuar kërkesën për rishqyrtim në modulën Kërkesat për rishqyrtim në platformën E-prokurimi. Ne si AK, ju falënderojmë për pjesëmarrjen në këtë tender, dhe ju inkurajojmë që të merrni pjesë edhe në tenderë tjerë të hapur nga ne si MASHTI.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 04.11.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1013/2024, ndërsa me datë 14.11.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/1013 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim. Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet

rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Ananas -Impex” SH.P.K., - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1013 ka vlerësuar si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit me titull: “Furnizim me ushqim dhe material higjienik për Qendrat Burimore dhe shkollat speciale” me nr. të prokurimit: "208 Udhëheqesi-24-8228-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E ARSIMIT, procedurë e hapur, kontratë kornizë me një operator ekonomik, lloji i kontratës furnizim, kriteri çmimi më i ulët.

AK në vendimin B58 të datës 30/09/2024 shpallë të rekomanduar për kontratë OE Edukimi SHPK, ndërsa OE ankuesin Ananas-Impex SHPK shpallë të eliminuar me arsyetimin:

Në ankesën e parashtruar nga OE ankues, pretendohet se Autoriteti Kontraktues nuk ka vlerësuar drejtë ofertat duke e shkelur Ligjin për Prokurim Publik përkatësisht nenet: 1,7,59,60,69 si dhe 97.1 të RRPP-së nr.001/2022.

OE ankues pretendon se i plotëson kërkesat e Dosjes së Tenderit, për arsye se posedon referencat konform kërkesës, paramasa e kërkuar me nënshkrim është në kundërshtim me rregullat për

prokurim publik pasi qe një gjë e tillë nuk është e mundur deri sa të kemi një vendim nga KRPP për nënshkrim elektronik. Gjithashtu AK na ka neglizhuar duke na dhënë qasje në orar të caktuar dhe në pamundësi që të arrijmë sipas orarit, dhe na refuzojnë qasjen për shkak se jemi vonuar rreth 10 minuta, duke na rekomanduar po ashtu të mos ushtrojmë ankesë pranë OSHP-së.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës të dokumentuara në E-prokurim sqaron se, AK në DT 9.1&9.2 ka kërkuar:

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se ngjashme në tri vitet e fundit, para datës së publikimit të njoftimit për kontratë, në vlerë 180,000 euro.

1. Një Listë e furnizimeve të natyrës se ngjashme të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit duke saktësuar Furnizimet e kryera, shumën e kontratës vendin, datën si dhe numrin e prokurimit, kjo listë duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga kompania (original), po ashtu duke i bashkangjitur kopjet e referencave përkatëse ose raportet e pranimi si dëshmi se kontrata është përmbushur me sukses për 3 (tri) vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

Gjerësa në ofertën e OE ankues gjendet lista e projekteve, e cila ka përshkrimin “Furnizim me material ushqimor” për kompanitë private, duke bashkangjitur referenca të përgjithësuar, në të cilat nuk vërehet se çka është furnizuar, në mënyrë që të vërtetohet natyra e furnizimit, përjashtuar faturat e bashkangjitura për kompaninë Elkos SHPK i cili furnizim nuk është përmendur në listë të projekteve.

Mirëpo vlen të theksohet se, bazuar në udhëzuesin për prokurim publik nr.001/2023 pika iii:

Si e tillë, në referencat e bashkangjitura nga OE ankues, nuk janë evidentuar data e lëshimit. Andaj AK gjatë rivlerësimit rekomandohet që të kërkoj sqarime shtesë lidhur me referencat, në mënyrë që të vërtetohet data e liferimit përmes faturave të lëshuara ose transaksioneve bankare të pranuar nga OE ankues. Pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar.

Kurse, lidhur me mos nënshkrimin e paramasës, ekspertja shqyrtuese e konsideron si devijim i vogël, për arsye se meqenëse ofertimi bëhet në mënyrë elektronike, si dhe paramasa përmbanë emrin dhe mbiemrin e shënuar, ku ofertuesit ngarkojnë ofertat e tyre me emër dhe përdorues (user) të tyre atëherë konsideron se mund të merret e mirëqenë. Pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Ndërsa, sa i përket qasjes, bazuar në platformën E-prokurimi, me datë 07/10/2024 është i bashkangjitur procesverbal i mbi qasjen e kërkuar, pra OE ankues ka poseduar qasjen:

Si përfundim, duke qenë se në aktivitetin e prokurimit sipas paramasës është kërkuar furnizim i produkteve (artikuj ushqimor) e cila peshohet 75%, atëherë me qëllim që të respektohet neni 1, 6, 7, 72 i LPP-së, AK rekomandohet për Rivlerësim, për faktin se sipas sqarimeve më lartë, AK meqenëse nuk ka sqaruar referencat lidhur me natyrën e furnizimeve, datat, atëherë rekomandohet që të sqarohet, për arsye se referencat e dorëzuara nuk specifikojnë se për çfarë produkte ka bërë furnizim, transaksionet bankare ose faturat (evidentim i livrimit) etj,

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit,

konsideron se gjetjet e raportit të ekspertit shqyrtues vlerësimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i mbështet konstatimet e raportit të ekspertit shqyrtues, andaj paneli shqyrtues pa nevojë për sqarime tjera shtesë e vlerëson si pjesërisht të bazuar ankesën e OE ankues anulon njoftimin për dhënie të kontratës, ndërkaq aktivitetin e prokurimit e kthen në rivlerësim.

Në këtë mënyrë është gjetur se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Ananas -Impex” SH.P.K. është pjesërisht e bazuar.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit e sheh si pjesërisht të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me “Furnizim me ushqim dhe material higjenik për Qendrat Burimore dhe shkollat speciale” me nr. të prokurimit: 208 Udheheqesi-24-8228-1-2-1 të kthehet në rivlerësim si dhe AK të veprojnë në raport me dispozitat ligjore të LPP-së duke e pasur parasysh nenin 72 të LPP

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E ARSIMIT**
- **OE - Ananas -Impex SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: